

BULETIN INFORMATIV

Aktivitetet e muajit Qershor 2026

www.cp-project.al info@cp-project.al



Trajnimi i Patrullës së Përgjithshme dhe personelit të SKK për Zbatimin e PK – Drejtoria Vendore e Policisë Kukës

Në datat **02-04 qershor 2026** dhe **09-10 qershor 2026**, 2 grupe të përberë nga Oficerë të Patrullës së Përgjithshme dhe personel të Sallës së Komandës dhe Kontrollit të Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës morën pjesë në një trajnim të organizuar nga Ekipi i Menaxhimit të Programit SCPA, i zhvilluar në ambientet e DVP Kukës dhe Komisarariatit Tropoje. Numri i pjesëmarrësve ishte në total **42** Punonjës policie.

Gjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit u njohën si me pjesën teorike ashtu edhe me ushtrimet praktike dhe me punën në grup, duke u fokusuar në filozofinë e Policimit në Komunitet dhe zbatimin e elementeve të saj në punën e përditshme të oficerëve të Policisë së Shtetit.

Gjithashtu, atyre iu prezantuan situata/ushtrime praktike për t'u trajtuar dhe zgjidhur prej tyre teksta punuan në grup me synimin për të siguruar masat që duhen marrë në mënyrë proaktive për zbatimin e elementeve të Policimit në Komunitet.

Vëmendje e veçantë iu kushtua trajtimit të rasteve të **Dhunës në Familje** si në aspektin teorik ashtu

edhe atë praktik. Me qëllim për të ofruar module trajnimi gjithëpërfshirëse, ekipi i Programit SCPA bashkëpunoi me **Qendrën e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm**, ekspertët e së cilës ofruan leksione ndërvepruese mbi luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Praktikat më të mira të BE-së për zbatimin e filozofisë së PK u ndanë e shkëmbyen me oficerët e PSH. Në përfundim të këtij trajnimi, oficerët e PSH arrijnë të përmirësojnë njohuritë dhe kapacitetet e tyre për zbatimin e Policimit në Komunitet.



AKTIVITETET KRYESORE:

- ♦ Trajnimi i Patrullës së Përgjithshme dhe personelit të SKK për Zbatimin e Policimit në Komunitet – Drejtoria Vendore e Policisë Kukës
- ♦ Skema e Granteve-Aktivitetet ndërgjegjësimi kundër dhunës dhe bullizmit
- ♦ Aktivitete mbështetur nga skema e granteve për forcimin e MKR-ve
- ♦ NSPK-të për edukimin vazhdojnë punën ndërgjegjësuere në shkolla



Skema e Granteve-Aktivite ndërgjegjësimi kundër dhunës dhe bullizmit



Gjatë muajit qershor 2026, u zhvilluan disa aktivitete në kuadër të Skemës së Granteve të Programit SCPA, të fokusuar në parandalimin e dhunës dhe bullizmit tek fëmijët dhe të rinjtë:

1. Shfaqje teatrale shëtitëse në Libohovë (25 qershor)

Qendra Kulturore Multifunkionale "Antigone" prezantoi një shfaqje teatrale të përgatitur dhe interpretuar nga të rinjtë, me mesazhe kundër bullizmit në shkollë dhe komunitet. Rreth 50 pjesëmarrës (nxënës, prindër, mësues, punonjës socialë, psikologë) ndoqën shfaqjen, e ndjekur nga një

bashkëbisedim i hapur me aktorët. Aktiviteti është pjesë e projektit "Nga ndërgjegjësimi te veprimi" dhe do të vazhdojë në bashki të tjera të Gjirokastrës.

2. Sesion informues në Maliq (3 qershor)

Shoqata "Unë, Gruaja" organizoi një takim me nxënës të gimnazit "Nefail Rozani" në Podgorie, mbi rreziqet e dhunës dixhitale dhe mbrojtjen online. Morën pjesë përfaqësues të Policisë së Shtetit, Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe shërbimeve sociale. U diskutuan raportimi i dhunës online

dhe mbrojtja e të dhënave personale, në kuadër të projektit "Parandalojmë dhunën në familje përmes koordinimit institucional".

3. Sesion me nxënës në Shkollën "Lidhja e Prizrenit"

Instituti për Zhvillim Strategjik (IZHS) zhvilloi një diskutim me nxënës mbi bullizmin, sigurinë digjitale dhe marrëdhëniet e shëndetshme, duke theksuar rëndësinë e krijimit të hapësirave ku të rinjtë ndihen të sigurt të kërkojnë ndihmë. Ky aktivitet u organizua në kuadër të projektit "Vendimarrja që Mbron".

Aktivitete mbështetur nga skema e granteve për forcimin e MKR-ve



Në kuadër të Skemës së Granteve të Programit SCPA, organizata "Gruaja tek Gruaja" zhvilloi dy takime me anëtarët e MKR-së:

Takimi në Malësi e Madhe (19 qershor)

Qëllimi ishte vlerësimi i funksionimit të mekanizmit gjatë gjashtëmuajorit të parë të 2026-s. Morën pjesë Koordinatorja Vendore për Dhunën në Familje, Policia e Shtetit dhe përfaqësues të njësive administrative.

U vlerësua pozitivisht koordinimi ndërinstitutional në identifikimin dhe

referimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Si sfida kryesore u përmend mungesa e burimeve njerëzore në disa njësi administrative, ndërsa u theksua nevoja për vazhdimësinë e trajnimeve dhe përditësimin e njohurive mbi ndryshimet ligjore.

2. Takimi në Vau Dejës (3 qershor)

Fokusi ishte informimi mbi ndryshimet e fundit në kuadrin ligjor për parandalimin e dhunës në familje. Morën pjesë përfaqësues nga arsimi, policia, shërbimet sociale e shëndetësore dhe shoqëria civile.

U evidentuan sfida si moszbatimi i plotë i Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM), vështirësitë e grave në zonat rurale për punësim dhe trajnime, si dhe mungesa e mbledhjeve të rregullta të MKR-së.

Të dy takimet konfirmuan angazhimin institucional për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mekanizmave të referimit për rastet e dhunës në familje dhe me bazë gjinore.

NSPK-të për edukimin vazhdojnë punën ndërgjegjëse në shkolla



Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe Ministrisë së Brendshme, si dhe në përputhje me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1076, datë 14.09.2022, "Për zbatimin e Programit 'Siguria e të Rinjve' në shkollat 9-vjeçare publike dhe jo publike," Ndhmës Specialistët e Policimit në Komunitet për Edukimin dhe Punën me të Rinjtë kanë vijuar me përkushtim aktivitetet e tyre gjatë muajit **Qershor 2026**.

Objektivi kryesor i këtij programi është ngritja e ndërgjegjësimi të të rinjve kundër përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogës.

Në kuadër të këtij programi, NSPK-të kanë bashkëpunuar ngushtësisht me koordinatorët vendorë të Zyrave Arsimore Vendore (ZAV), duke hartuar së bashku një kalendar të detajuar mujor për zhvillimin e temave në shkollat 9-vjeçare që ndodhen brenda zonave të tyre policore. Gjatë muajit Qershor, fokusi i veçantë ka qenë te

temat e ndërgjegjësimi për sigurinë rrugore të cilat përbëjnë prioritet në edukimin e fëmijëve për mbrojtjen e jetës dhe parandalimin e rreziqeve të mundshme në përditshmërinë e tyre.

Gjithashtu, janë trajtuar edhe tema të tjera që lidhen me edukimin qytetar, në bazë të kërkesave të komunitetit arsimor dhe situatave specifike të secilës zonë.

Përmes platformës online të monitorimit të aktiviteteve, është vërejtur një angazhim i shtuar nga ana e NSPK-ve që operojnë në komisaritet e qyteteve **Tiranë, Shkodër, Lezhë, Berat, Korçë, Pogradec, Fier, Lushnje, Durrës, Kurbin, Gjirokastrë, Kukës, Vlorë dhe Sarandë**.

Këto njësi kanë treguar një intensitet të lartë pune, duke realizuar takime të shumta dhe duke shpërndarë materiale ndërgjegjëse përmes rrjeteve sociale dhe forumeve online.

Në total, janë postuar **101** materiale dhe aktivitete që janë parë në mënyrë interaktive nga **980** përdorues, duke

dëshmuar një interes të madh nga publiku.

Për më tepër, janë regjistruar gjithsej **34** komente në këto postime, të cilat në pjesën më të madhe kanë qenë pozitive, përshëndetëse dhe vlerësuese për punën dhe përkushtimin e treguar nga specialistët e Policisë së Shtetit.

